



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë – Ministarstva Prave – Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministra Prave - Cabinet of the Minister of Justice

Nr. 17/2024
Datë: 30/01/2024

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, në përputhje me nenin 11 (paragrafi 1, në-paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores (QRK)-nr.14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, si dhe në pajtim me nenin 7 (paragrafi 4) të Rregullores (QRK)-nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar, Ministria e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Plani Legjislativ për projekt aktet nënligjore për vitin 2024 në Ministrinë e Drejtësisë.
2. Plani nga pika 1 e këtij vendimi përfshinë projekt aktet nënligjore, si në vijim:
 - 2.1. Projekt Rregullore për organizimin e brendshëm dhe funksionimin e Shërbimit Korrektues të Kosovës (28.02.2024);
 - 2.2. Projekt Rregullore për organizimin e brendshëm dhe funksionimin e Shërbimit Sprovues të Kosovës (28.02.2024);
 - 2.3. Projekt Rregullore për organizimin e brendshëm dhe funksionimin e Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë (28.02.2024);
 - 2.4. Projekt Rregullore për organizimin e brendshëm dhe funksionimin e Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar (28.02.2024);
 - 2.5. Projekt Rregullore për organizimin e brendshëm dhe funksionimin e Agjencinë për Ndihmë Juridike falas (28.02.2024);
 - 2.6. Projekt Rregullore për organizimin e brendshëm dhe funksionimin e Avokaturës Shtetërore (28.02.2024);
 - 2.7. Projekt Udhëzim Administrativ për procedurat dhe afatet për akreditimin e laboratorëve mjeko ligjor dhe hapësirave të tjera mjeko ligjore (29.03.2024).

- 2.8. Projekt Udhëzim Administrativ për procedurat dhe shqiptimin e masave disiplinore (29.03.2024);
- 2.9. Projekt Udhëzim Administrativ për tarifatat dhe kompensimin e shërbimeve të kryera nga avokatët lidhur me shërbimet e autorizuara të ndihmës juridike falas (29.03.2024);
- 2.10. Projekt Udhëzim Administrativ për procedurat e angazhimit të avokatëve në shërbimet e autorizuara të ndihmës juridike falas (29.03.2024);
- 2.11. Projekt Udhëzim Administrativ për kushtet e punës, duke përfshirë edhe kompensimin në rast të paaftësisë për punë (29.03.2024);
- 2.12. Projekt Udhëzim Administrativ për mbajtjen dhe grumbullimin e evidencave për personat ndaj të cilëve ekzekutohen sanksione penale (30.05.2024);
- 2.13. Projekt Udhëzim Administrativ për kriteret dhe afatet kohore të përpilimit të raporteve dhe mbikëqyrjes së personave të liruar me kusht (30.04.2024);
- 2.14. Projekt Udhëzim Administrativ për procedurat dhe kushtet për gradim të zyrtarëve korrektues (30.04.2024);
- 2.15. Projekt Udhëzim Administrativ lidhur me të dhënat e personit që gjendet në paraburgim (30.04.2024);
- 2.16. Projekt Udhëzim Administrativ për rregullimin më të përafërt për ushqimin e personave të dënuar (30.05.2024);
- 2.17. Projekt Udhëzim Administrativ për procedurën disiplinore, klasifikimin dhe shqiptimin i dënimeve disiplinore (29.03.2024);
- 2.18. Projekt Udhëzim Administrativ për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për mbulimin e shpenzimeve për ofrimin e shërbimeve edukative, shëndetësore apo rehabilituese për fëmijët me aftësi të kufizuar në një komunë tjetër nga ajo ku jeton (30.01.2024);
- 2.19. Projekt Udhëzim Administrativ për parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijëve në Kosovës (29.02.2024);
- 2.20. Projekt Udhëzim Administrativ për përcaktimin e strukturës dhe mekanizmave institucional për bashkëpunim me organizatat jo qeveritare për realizimin e politikave për të drejtat e fëmijës si dhe për ofrimin e shërbimeve të nevojshme për mbrojtjen e tyre (29.03.2024);
- 2.21. Projekt Udhëzim Administrativ për përcaktimin e procedurave efektive për identifikimin, raportimin, referimin, shfrytëzimin, neglizhimin dhe abuzimin e fëmijës si dhe për mbrojtjen e fëmijës në situatë rruge (29.03.2024);
- 2.22. Projekt Udhëzim Administrativ për ndryshim plotësimin e Udhëzimit Administrativ MD-nr. 06/2022 për mënyrën e dhënies dhe programin e provimit të jurisprudencës (28.02.2024);

- 2.23. Projekt Udhëzim Administrativ për ndryshim plotësimin e Udhëzimit Administrativ MD-nr. 01/2019 për mënyrën e dhënies dhe programin e provimit të noterisë (28.02.2024);
- 2.24. Projekt Udhëzim Administrativ për ndryshim plotësimin e Udhëzimit Administrativ MD-nr. 02/2013 programin dhe mënyrën e dhënies së provimit për përmbarues privat (28.02.2024);
- 2.25. Projekt Udhëzim Administrativ për ndryshim plotësimin e Udhëzimit Administrativ MD-nr. 03/2017 për procedurat e organizimit, përmbajtjes dhe mbajtjes së provimit për administratorë falimentues (28.02.2024);
- 2.26. Projekt Udhëzim Administrativ për përcaktimin e standardeve profesionale për përmbaruesit privat (28.02.2024);
- 2.27. Projekt Udhëzim Administrativ për plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzimit Administrativ MD-nr. 04/2019 për mbikëqyrjen, përgjegjësinë dhe procedurën disiplinore të ndërmjetësuesve (28.02.2024);
- 2.28. Projekt Udhëzim Administrativ për punën e Komisionit dhe kriteret e vlerësimit për Provimin e Jurisprudencës (28.02.2024);
- 2.29. Projekt Udhëzim Administrativ për përmbajtjen e procesverbalit, formularit të certifikatës për dhënien e provimit, dhe përmbajtja e evidencës për provimin e dhënë të jurisprudencës (28.02.2024);
- 2.30. Projekt Udhëzim Administrativ për rregullimin e procedurës disiplinore për ekspertët gjyqësor (30.05.2024);
- 2.31. Projekt Udhëzim Administrativ për Kodin e Etikës dhe Mirësjelljes së ekspertëve gjyqësor (30.05.2024);
- 2.32. Projekt Udhëzim Administrativ për tarifat për kryerjen e ekspertizës dhe kompensimin e shpenzimeve të shërbimit për ekspertët gjyqësor (30.05.2024);
- 2.33. Projekt Rregullore për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores MD - nr.07/2023 për procedurën e përcaktimit dhe verifikimit të reciprocitetit, kushtet, përmbajtjen dhe mënyrën e mirëmbajtjes së bazës së të dhënave për fitimin e të drejtës së pronësisë mbi pronën e paluajtshme nga të huajt në Kosovë (28.02.2024);
- 2.34. Projekt Udhëzim Administrativ për ruajtjen e rezultateve të ekzaminimit molekular dhe gjenetik (29.03.2024);
- 2.35. Projekt Rregullore për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores MD-nr. 01/2020 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Institutin e Mjekësisë Ligjore (29.03.2024);
- 2.36. Projekt Udhëzim administrativ për mënyrën e mirëmbajtjes, sigurisë dhe përdorimit të sistemit dhe nxjerrjen e raporteve publike duke siguruar konfidencialitetin për viktimën (30.05.2024);

- 2.37. Projekt Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Koordinatorit Kombëtar për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe funksionimin e Grupit Koordinues Ndërmnistror (30.08.2024);
- 2.38. Projekt Udhëzim Administrativ për krijimin e fondit emergjent për nevojat e viktimave gjatë periudhës kur ata/ato janë në polici (30.08.2024);
- 2.39. Projekt Udhëzim Administrativ për linjën telefonike urgjente për viktimat e dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës në baza gjinore (30.08.2024);
- 2.40. Projekt Rregullore për Mekanizmat Koordinues Lokal për mbrojtje nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në bazë gjinore (30.08.2024);
- 2.41. Projekt udhëzim administrativ për procedurat e shpërndarjes, monitorimit, licencimit dhe financimit të strehimoreve të specializuara për strehimin e viktimave të dhunës (30.08.2024);
- 2.42. Projekt Udhëzim Administrativ për ndryshim plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.08-2022 për mbrojtjen juridike të personave të akuzuar potencial për krimet e pretenduara në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara (15.02.2024);
- 2.43. Projekt Udhëzim Administrativ për shërbimet e integruara (30.09.2024);
- 2.44. Projekt Udhëzim Administrativ për procedurën e caktimit të kujdestarisë, llojet e kujdestarisë dhe çështjeve të tjera lidhur me kujdestarinë (30.09.2024);
- 2.45. Projekt Rregullore për organizimin, detyrat dhe përgjegjësitë e Panelit për Strehim Familjar (28.06.2024)
- 2.46. Projekt Udhëzim Administrativ për shërbimet e strehimit, llojet e strehimit, llojet dhe numrin e përfituesve të vendosur, dhe çështjet tjera lidhur me strehim (30.09.2024);
- 2.47. Projekt Rregullore për organizimin, detyrat dhe përgjegjësitë e Panelit për Strehim Rezidencial (28.06.2024);
- 2.48. Projekt Udhëzim Administrativ për kushtet për ofrimin e strehimit rezidencial, llojet e strehimit, kushtet për kryerjen e strehimit, llojet dhe numrin e përfituesve të vendosur (28.06.2024);
- 2.49. Projekt Rregullore për organizimin, detyrat dhe përgjegjësitë e Panelit për Adoptim (31.07.2024);
- 2.50. Projekt Udhëzim Administrativ për procedurat për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në procesin e adoptimit (31.07.2024);
- 2.51. Projekt Udhëzim Administrativ për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në procesin e mbështetjes së jetesës së pavarur dhe të mbikëqyrur dhe aftësimin për jetën dhe punën e pavarur (29.11.2024);
- 2.52. Projekt Udhëzim Administrativ për kriteret dhe mënyrën e licencimit të profesionistëve individual që ofrojnë shërbime sociale (31.05.2024);

- 2.53. Projekt Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Profesional për Shërbime Sociale dhe Familjare (31.05.2024);
 - 2.54. Projekt Rregullore për kushtet minimale për themelimin e institucioneve të shërbimeve sociale (30.08.2024);
 - 2.55. Projekt Rregullore për organizimin, përgjegjësitë, llojin dhe numrin e profesionistëve si dhe funksionimi i Qendrës për Punë Sociale (30.08.2024);
 - 2.56. Projekt Rregullore për organizimin dhe fushëveprimin e Qendrave për Kujdes Ditor (31.10.2024);
 - 2.57. Projekt Rregullore për organizimin dhe fushëveprimin e Qendrave për Pranim (30.08.2024);
 - 2.58. Projekt Udhëzim Administrativ për shërbimet sociale dhe familjare nga vullnetarët (29.11.2024);
 - 2.59. Projekt Udhëzim Administrativ për procedurën për dhënien, përsëritjen, pezullimin dhe marrjen e licencës (31.05.2024);
 - 2.60. Projekt Udhëzim Administrativ për kriteret dhe kushtet për marrjen e licencës për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare nga punonjësit profesional (30.05.2024);
 - 2.61. Projekt Udhëzim Administrativ për mënyrën e inspektimit të ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare (31.07.2024);
 - 2.62. Projekt Udhëzim Administrativ për procedurën, kushtet dhe parimet e zbatimit të partneritetit publiko-privat në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare (30.09.2024);
 - 2.63. Projekt Udhëzim Administrativ për mbajtjen e evidencës unike dhe të dokumentacionit të përfituesve të të drejtave, formës, masave dhe shërbimeve nga përkujdesi social dhe familjar (30.09.2024);
 - 2.64. Projekt Udhëzim Administrativ për përmbajtjen e licencës (31.05.2024);
 - 2.65. Projekt Rregullore për ndërprerjen e kërkimit të personave të zhdukur (30.09.2024);
 - 2.66. Projekt Udhëzim Administrativ për kartelën identifikuese të ekspertëve gjyqësor (28.06.2024).
 - 2.67. Projekt Rregullore për Organizimin dhe Fushëveprimin e Shtëpive për Mbrojtjen e Fëmijëve (29.02.2024).
3. Obligohen Agjencitë/Departamentet/Divizionet/Njësitë përkatëse të Ministrisë së Drejtësisë për hartimin e projektit fillestar të akteve nënligjore nga pika 2 e këtij vendimi, dhe atë si në vijim:
 - 3.1. Shërbimi Korrektues i Kosovës, projekt aktet nënligjore nga pika 2.1, 2.8, 2.11, 2.12, 2.14, 2.15, 2.16, dhe 2.17.

- 3.2. Shërbimi Sprovues i Kosovës, projekt aktet nënligjore nga pika 2.2, 2.13.
 - 3.3. Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Konfiskuar dhe Sekuestruar, projekt aktin nënligjor në pikën 2.4.
 - 3.4. Instituti i Mjekësisë Ligjore, projekt aktin nënligjor nga pika 2.7, 2.34, 2.35.
 - 3.5. Avokatura Shtetërore, projekt aktin nënligjor nga pika 2.6.
 - 3.6. Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë, projekt aktin nënligjor nga pika 2.3.
 - 3.7. Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, projekt aktet nënligjore nga pika 2.5, 2.9 dhe 2.10;
 - 3.8. Departamenti Ligjor, projekt aktin nënligjor nga pika 2.33, 2.36, 2.37, 2.38, 2.39, 2.40, 2.41, 2.65.
 - 3.9. Departamenti për Profesione të Lira, projekt aktet nënligjore nga pika 2.22, 2.23, 2.24, 2.25, 2.26, 2.27, 2.28, 2.29, 2.30, 2.31, 2.32 dhe 2.66.
 - 3.10. Departamenti për Politikën e Shërbimeve Sociale dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, projekt aktet nënligjore nga pika 2.18, 2.19, 2.20, 2.21, 2.43, 2.44, 2.45, 2.46, 2.47, 2.48, 2.49, 2.50, 2.51, 2.52, 2.53, 2.54, 2.55, 2.56, 2.57, 2.58, 2.59, 2.60, 2.61, 2.62, 2.63, 2.64, 2.67.
 - 3.11. Divizioni për koordinimin e procesit për mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare të personave të akuzuar potencial në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara, projekt aktin nënligjor nga pika 2.42.
4. Projekti fillestar sipas paragrafit 3 të këtij vendimi, i përfunduar, i dërgohet Departamentit Ligjor të Ministrisë së Drejtësisë për shqyrtim sipas afatit të përcaktuar.
 5. Departamenti Ligjor pas përfundimit të shqyrtimit e procedon gjithë dokumentacionin për shqyrtim dhe miratim në pajtim me Rregulloren Nr.09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
 6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Vendimi iu dërgohet:

- Udhëheqësve të Agjencive/Departamenteve/Divizioneve/Njësive;
- Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;
- Zyrës Ligjore të ZKM-së;
- Departamentit Ligjor/MD; dhe
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.